



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**  
**SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË**  
**DELEGUARA**

Nr. 29/1 prot.

Elbasan, më 6.3.2025

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.21, datë 26.02.2025 "Për miratimin e instruktorëve të jashtëm pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve, me honorare", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1208 prot

**VENDIM**

**Datë.28.02.2025**

**Nr.21 dt.26.02.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E INSTRUKTORËVE TË JASHTËM PRANË QENDRËS KULTURORE  
TË FËMIJËVE, ME HONORARE.**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 date 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen vendore” neni 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , Ligiin Nr.7961, date 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës se Shqipërisë", (të ndryshuar), Vendimin nr.425, date 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucione arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, pika 8 shkronja (b), në Vendimin nr.107, datë 27.12.2024 të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionareve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civile e të punonjësve administrative të bashkisë Librazhd dhe Institucioneve të varësisë”.Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 26.02.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë emërimin e instruktorëve të jashtëm pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve me honorare, sipas VKM NR.425, datë 26/06/2024, pika 8 shkronja (b)..
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social, Sekretari i Përgjithshëm dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes .

SEKRETAR I KËSHILLIT  
**Elson MALLUTA**

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT  
**Silvana HOXHA**

